

Ish-gruaja e kamikazit të Parisit, Ibrahim Abdeslam, ka thyer heshtjen dhe ka zbuluar se ai ishte i papunë, tymoste hashash gjithë ditën, ka qenë për pak kohë në burg për vjedhje dhe kurrë nuk ka shkuar në xhami.

“Aktivitetet e tij të preferuara ishin tymosja e hashashit dhe gjumi. Ibrahim nuk kishte asnjë punë ndaj qëndronte në shtëpi gjatë gjithë ditës, duke parë DVD dhe dëgjonte muzikës arabe hip-hop. Ne kemi jetuar me pagesën e papunësisë e cila ishte vetëm 1,000 euro në muaj ndaj shqetësoheshim shumë për para. Ne nuk kemi fëmijë. Ibrahim nuk i ndiqte kurrë lajmet në televizor dhe nuk kishte asgjë kundër Perëndimit. Ai ishte i ftohtë në dukje por me karakter të mirë. Nuk ishte i dhunshëm me mua apo me të tjerët”, rrëfeu ish-bashkëshortja e kamikazit.

Naima u martua me Ibrahim Abdeslam në vitin 2006 dhe martesë e tyre zgjati vetëm dy vjet./bw/